



AUDITUESE LIGJORE
FATMIRA SYKJA - KASTRATI


KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 334 J/PROT
7.10.2024

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR
PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 06
MARS 2022 TË SUBJEKTIT ELEKTORAL PARTIA "LËVIZJA SOCIALISTE PËR
INTEGRIM"

(Hartuar sipas formatit të standartizuar me vendimin nr. 9, datë 29 janar 2022 të Komisionit Rregullator të KQZ-së-)

1



Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 06 MARS 2022 TË SUBJEKTIT ELEKTORAL PARTIA “LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM”

2

I. Informacion i Përgjithshëm

A. Informacion ligjor

Përmbushja e detyrës sime për kryerjen e auditimit ligjor detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06 mars 2022, për subjektin zgjedhor partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, u krye sipas vendimit nr.138, të datës 18 mars 2022 të të KQZ-së, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022”

Realizimi i këtij misioni ka këtë bazë ligjore si më poshtë renditur:

i. Kuadri ligjor

- Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar” i ndryshuar;
- Standartet ndërkombetare të auditimit;
- Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017;
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.138, të datës 18 mars 2022 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022”;
- Udhëzimit nr. 14, datë 9 qershor 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore” dhe vendimit nr. 15, dt.26.01.2022 të

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

KQZ-së, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore";

- Formatet tip të raportimit financiar të fushatës zgjedhore për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, model i miratuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator, të shpallura në faqen zyrtare të KQZ-së https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/dkfab_220129_Vendimi-nr.9_date_220129_Per_percaktimin-e-rregullave-per-raportimin-financiar-te-partive-politikesubjekteve-zgjedhore-kontrollin-dhe-verifikimin-e-financimeve-dhe-shpenzimeve.pdf;
- Legjislacioni tatimor në fuqi.

ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme:

- Standartet kombëtare të kontabilitetit (SKK-të)

B. Objekti i auditimit

i. Kontrata e shërbimit

Kryerja e misionit të auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, u realizua sipas kontratës të lidhur midis KQZ-së, me nr. prot. të saj 2639, dt.07.06.2022, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe audituese ligjore, znj. Fatmira KASTRATI (SYKJA), anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 14, datë 11.01.2000, me NIPT K46523036S.

Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe kandidatë të listave shumë-emërore në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi nr.138, i datës 18 mars 2022 i KQZ-së, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022", që ka shpallur rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe kandidatë e listave shumëemërore, solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 2639, dt.7.6.2022 përshkruar më sipër në pikën i.

4

Me këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më ka emëruar, me cilësinë e Auditit Ligjor, **të auditoj fondet** e përftuara dhe të shpenzuara nga partia politike "Lëvizja Socialiste për Integrim" gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar, model i miratuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator, të shpallura në faqen zyrtare të KQZ-së, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar, i cili nuk duhet të përmbajë anomali materiale për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), të pranojë dhe të kuptojë se ka përgjegjësi:

- Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportimeve financiare tip-standart në pajtim me kërkesat specifike si të ligjit "Për partitë politike" i ndryshuar, ashtu dhe të udhëzimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- Për kontrollet e brendshme, të atilla që drejtimi i Partisë i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e raportimeve financiare tip standard, të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt.06.03.2022, pa anomali materiale nga mashtrimi apo nga gabimi;

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Regjistrin e posaçëm, sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja për shumën e fondeve të përfitura nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhënat që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit;
- Deklaratat e dhurimit sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja;
- T'i japë audituesit:
 - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e raportimeve financiare tip standart, të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt. 06.03.2022, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit;
 - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda Partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë nga drejtimi i Partisë, kur është e përshtatshme edhe nga personat e ngarkuar me administrimin, që të marrim prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

Përgjegjësitë e audituesit

- Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë të auditimit sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe është kryer në përputhje me SNA-të.
- Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse raporti financiar i raportuar, i partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim" për zgjedhjet e pjesshme vendore të dates 06 mars 2022, në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë por, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, është krijuar më 06 shtator 2004. Është regjistruar në regjistrin e partive politike, me vendimin nr.4274, datë 23 shtator 2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Në organet tatimore, partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, është regjistruar më 16 tetor 2009 me NIPT K51611030T. Aktet e themelimit dhe të ndryshimeve të drejtimit të kësaj Partie janë të depozituara në regjistrin e partive politike.

Drejtimi i sotëm i Partisë bëhet nga zj. Monika Kryemadhi.

Adresa zyrtare e selisë së Partisë është rruga Rruga Sami Frashëri, Godina 20/10, Tiranë 1001.

Në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06 mars 2022, partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” paraqitet në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”. Ky Koalicion është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06 mars 2022 me vendimin nr. 46¹, datë 4 shkurt 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përbërje të tij janë partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe “Partia Demokristiane e Shqipërisë. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore “Sh-L”.

Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, me shkronja nistore “Sh-L”, në këtë fushatë zgjedhore u përfaqësua me 6 (gjashtë) kandidatë në këto 6 (gjashtë) bashki²:

- Në bashkinë e Durrësit,
- Në bashkinë e Dibrës,
- Në bashkinë e Shkodrës,
- Në bashkinë e Vorës,
- Në bashkinë e Rogozhinës,
- Në bashkinë e Lushnjës.

ii. Forma e organizimit dhe e menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ka rreth 41.000 anëtarë. Ajo ka degët e saj në të gjitha qarqet dhe njësitë administrative të vendit.

Simboli i partisë është LSI (shkurtim i emrit “Lëvizja Socialiste për Integrim”).

Në nivel vendor, partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ka organizimin si vijon:

- Organizata pranë qendrës së votimit

¹ https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Vendim_46_220204_Regjistrimi-Koalicioni-Shtepia-e-Lirise-SHL-1.pdf

² https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/220226_Lista_e_kandidateve.pdf

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Komiteti drejtues pranë njësisë së votimit
- Konventa e rrethit
- Komiteti drejtues i rrethit
- Kryesia e rrethit

Në nivel qendror partia ka organizimin si vijon:

- Konventa Kombëtare
- Komiteti Drejtues Kombëtar
- Kryesia
- Kryetari
- Zv. Kryetari
- Nënkryetarët
- Sekretari i përgjithshëm.

7

D. PARAQITJA E RAPORTIT TË AUDITIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportimit të auditimit, kërkesat formale, të ardhurat , shpenzimet

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” ka dorëzuar formatin e standartizuar të raportit financiar të fushatës zgjedhore, të aprovuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator, të shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së³.

Auditimi është kryer në zyrën e Auditueses Ligjore si dhe në ambientet e Partisë ku është kontrolluar dhe marrë dokumentacioni, përfshirë edhe komunikimin nëpërmjet telefonit e postës elektronike.

Komunikimi i parë është realizuar në ambjentet e selisë së partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim” me datë 4 gusht 2022, e konkretisht me zj. Elena Gace, zj. Jorida Prifti e z. Georges Gostivishti. Me datë 5 gusht 2022, më janë dërguar nëpërmjet postës elektronike dokumentet e kërkuara me dt. 04.08.2022. Me 23 gusht 2022, më janë dorëzuar edhe fizikisht dokumentet e dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Për arsye familjare, komunikimet me LSI-në kanë rifilluar me datë 19 shtator 2022. Nga kjo datë e deri me 4.10.2022, kam pasur lidhje të vazhdueshme telefonike për të marrë sqarime të mëtejshme si me zj. Elena Gace ashtu dhe me z. Georges Gostivishti, ku u kërkuan dokumente dhe sqarime shtesë të tjera.

³https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/dkfab_220129_Vendimi-nr.9_date_220129_Per-percaktimin-e-rregullave-per-raportimin-financiar-te-partive-politikesubjekteve-zgjedhore-kontrollin-dhe-verifikimin-e-financimeve-dhe-shpenzimeve.pdf



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

8

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	13.05.2022
	b) dorëzim fizik	Po	13.05.2022
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	13.05.2022
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i finances			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po	Banka Credins, IBAN AL2821211009000000001647007 ⁴
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po	Është dorëzuar nga Partia.
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Personi i shpallur në KQZ si përgjegjës për financën është z. Flobens Dilaveri

B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

○ Llogaria bankare

Partia, "Lëvizja Socialiste për Integrim" ka hapur llogari bankare tek "Credins bank", me datë 28.01.2022, me IBAN AL 2821211009000000001647007. Në faqen zyrtare të KQZ-së nuk janë shpallur informacionet për llogaritë bankare të subjekteve elektorale për vitin 2022.

⁴ Hapur me datë 28.01.2022. Është marrë informacioni nga partia LSI. Në faqen zyrtare të KQZ-së nuk janë shpallur informacionet për llogaritë bankare të subjekteve elektorale për vitin 2022

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Partia, "Lëvizja Socialiste për Integrim" ka njoftuar KQZ-në për hapjen e llogarisë së posaçme bankare tek "Credins bank", bashkë me regjistrimin për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie për bashkitë Durrës, Shkodër, Lushnje, Dibër, Vlorë dhe Rrogozhinë, me shkresën me nr. prot. të saj in 28, datë 31.01.2022;
 - Nuk ka deklarime për llogari bankare të tjera që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
 - Nga shqyrtimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore, dorëzuar në KQZ sipas formatit të aprovuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator, të shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së, të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në vlerën 13,779,494.90 lekë. Subjekti zgjedhor paraqet në raportin financiar të saj që ai është i balancuar dhe nuk ka deficit.
- o **Plotësia e informacionit**
- Është hapur llogari e veçantë për këtë fushatë, sa më sipër sqaruar, si dhe është dorëzuar dokumenti i lëvizjeve të kësaj llogarie, ku shihet që s'ka veprime të regjistruara për këtë fushatë zgjedhore.

b/ Personi përgjegjës për financën/financieri

- o **Identiteti i personit përgjegjës për financën (financieri):**
- Personi përgjegjës i financave sipas raportit financiar të Partisë, dorëzuar në KQZ është z. Flobens Dilaveri. Ky raport është miratuar dhe nga sekretari i përgjithshëm i saj, z. Endrit Braimllari
- o **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**

Raporti financiar i fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie për bashkitë Durrës, Shkodër, Lushnje, Dibër, Vlorë dhe Rrogozhinë, është firmosur nga z. Flobens Dilaveri dhe është miratuar nga sekretari i përgjithshëm, z. Endrit Braimllari

a) bosh/mungon informacioni	Jo	Nuk mungon informacioni	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat	Financime publike	0
		Donacione private	9,523,686.45

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

			Financim nga burimet e veta të partisë	4,153,417.45
			Huatë/Kreditë	0
		Shpenzimet		
			Mitingjet/tubime dhe aktivitete në fushatë	190,000
			Materialet promocionale	616,336.45
			Media	8,136,709.91
			Media Sociale	183,747.07
			Sondazhe	0
			Botime/Publikime	0
			Shpenzime zyre elektorale	259,180
			Transporti	0
			Konsulenca (studim tregu, marketing)	341,467.20
			Reklamime në natyre	0
			Shpenzime administrative	3,786,793.80

10

II. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

	Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik		
Fondi i marrë paradhënie	0	0
Data e marrjes së fondit		
Kompensimi financiar paszgjedhor		0
Data e marrjes së kompensimit financiar pas zgjedhor		
Diferenca e kthyer		
Data e kthimit të diferencës		
2/ Donacionet private		

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Shuma e përgjithshme e raportuar	9,523,368.45	9,545,686.02
Shuma e donacioneve në para	9,360,140.64	9,375,135.01
Shuma e donacioneve në natyrë	163,227.81	170,551.01
Përgatitet një listë e donatorëve		Po
Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		Jo
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		Jo
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		Po
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		Po
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		Po
A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		Po
Respektimi i kufirit të donacionit		Po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë		
Shuma e përgjithshme e raportuar	4,153,417.45	3,919,107.44
Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
Kuotat e anëtarësisë	288,760	288,760
Botimet	-	-
Shtypi i printuar	-	-
Shitja e publikimeve	-	-
Dhënia me qira	-	-
Interesat	112,000	112,000
Transfertë nga llogaritë e partisë	3,752,657.45	3,518,347.44
Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	-	-
Botimet	-	-
Shtypshkronja	-	-
Dhënie me qira	-	-
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	-	-

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		-
4/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	-	-
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.		

12

B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → _që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në deficit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruara nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve).

Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim" nuk ka marrë fonde publike për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022.

b/ Financimi nga burimet jo publike:

Financimet nga fondet jo publike, për zgjedhjet vendore të pjesshme për datën 6 mars 2022 të partisë "Lëvizja socialiste për Integrim", në mënyrë analitike paraqiten si vijon:

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Vlera në ALL
1	Donacione (sponsorizime)	7,001,804.82
2	Kandidatët	2,373,330.19
3	Kuota anëtarësie	288,760.00
4	Interesa bankare	112,000.00
5	Fonde nga partia LSI	3,518,347.44
6	Të ardhura në natyrë	170,551.01
7	Të ardhura në natyrë (LSI)	102,391.00
	TOTALI	13,567,184.46

13

- Donatorët e lejuar:

- Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
- Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e Partisë;

Kandidatët e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, udhëheqëse e të cilit ishte partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, kanë pasur financime, nga burime jo publike në fushatën zgjedhore të datës 06 mars 2022.

Sponsorizuesit e kandidatëve kanë nënshkruar deklaratën tip, të aprovuar me vendimin nr. 9, dt. 29.01.2022 nga Komisioni Rregullator i KQZ-së, mbi konfliktin e interesave për financimin e partive politike/subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për zgjedhjet vendore.

Kjo deklaratë tip, ku shkruhet që donacioni ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 92/1 paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është nënshkruar prej donatorit ose prej përfaqësuesit të tij ligjor.

Në dosjen e secilit donator, gjendet dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi, pasaporta e huaj por që i takon personit që njihet nga ligji si donator), vlera në lekë apo në monedhat euro e dollarë amerikanë e donacionit, data e donacionit si dhe nr. i llogarisë bankare prej nga xhirohet ky donacion dhe destinatarin e këtij dhurimi (raport ky i paraqitur me pasqyrat financiare të depozituara në KQZ).

- Burimet e palejuara

- Kontributet në natyrë

○ Vlerësimi:

- Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” nuk ka pasur burime të palejuara në fushatën zgjedhore të pjesshme për organet vendore të datës 6 mars 2022.

14

Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” ka paraqitur si kontribute në natyrë në fushatën zgjedhore të datës 6 mars 2022 vlerat e llogaritura të zyrave shtetërore që ajo përdor në bashkitë e qyteteve Berat, Kukës, Mallakastër dhe Pogradec.

Llogaritjet e kontributeve, si për kandidatët e Koalicionit ashtu dhe për qendrën e LSI-së, të përfituara nga dhënia në përdorim e ambienteve, është bërë sipas vendimit nr. 18, datë 14.04.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, ku përcaktohen rregullat dhe modalitetet për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike, të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.

Në raportin e paraqitur nga LSI-ja, janë të evidentuara në mënyrë të qartë statusi i dhuruesit, të dhënat identifikuese të dhuruesit, adresa e tij, vlera e llogaritur e dhurimit, data e dhurimit, destinacioni i kontributit si dhe përshkrimi i kontributit, i pronës dhe i pronarit.

Pra, kontributet në natyrë plotësojnë këto kritere si më poshtë:

- a) Janë në formë produkti të ofruar pa pagesë;
- b) Vlera e tyre përcaktohet nga dokumentacioni i mbajtur nga përfituesi, në rastin tonë nga LSI-ja;
- c) Këto dhurime janë të ardhura që nuk merren në formë monetare;
- d) Janë të regjistruara njësoj si dhurimet në para duke ua përlllogaritur vlerën e tyre monetare sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 10 datë 24.12.2020 të KQZ-së, Komisioni Rregullator ;
- e) Ato janë paraqitur në të ardhurat dhe në shpenzimet e fushatës.

○ Kufizimet

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e Partisë;
- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë- si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?)

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Pasi u kontrollua lista e dhurimeve në natyrë, u pa se nuk ka shkelje në shumën e përgjithme të donacionit nga një donator, pra asnjë donacion nuk i kalon kufijtë sipas përcaktimeve ligjore.

Ne kemi kontrolluar dokumentacionin fizik të subjektit. Pasi kemi hartuar tabelat individuale për individ apo kandidat, kemi hartuar tabelat e konsoliduara dhe në përfundim të tyre nuk kemi gjetur shkelje të ligjit apo të kriterëve të përcaktuara.

15

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë:**
 - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas datave dhe vlerave të arkëtuara në llogarinë bankare të Credins bank dhe BKT nga 28.01.2022-04.03.2022 e cila është paraqitur dhe në pasqyrën 2.d, "Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti- Të ardhura jo publike", është në vlerën 288,900 lekë;
 - o Botimet – nuk ka;
 - o Shtypi i printuar – nuk ka;
 - o Dhënie me qira, etj – nuk ka;
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës:**
 - o Zyra qendrore – ka të ardhurat që merren nga burimet e veta të Partisë të cilat i administron ajo vetë;
 - o Degët lokale, kandidatët- kanë vetëm të ardhurat e mbledhura nga kandidatët dhe nga donatorët.
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement ose nxjerrja e llogarisë)**

Nuk ka veprime të kryera nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme të hapur posaçërisht për fushatën zgjedhore të pjesshme të datës 06.03.2022.

d/ Huatë/Kreditë – nuk ka.

III. SHPENZIME

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	13,779,494.90 lekë	
----------------------------------	--------------------	--

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike per qellime zgjedhore, ne perputhje me nenin 88 te ligjit nr.10019, date 19.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar)

Subjekti nuk ka marrë fonde publike

Shpenzimet e kryera nga zyra qendrore e Partisë

	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet/tubime dhe aktivitete të fushatës				Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Materialet promocionale	129,216.45	129,216.45	129,216.45	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Media	58,227.20	58,227.20	58,227.20	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Media sociale	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Sondazhe	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Botime/publikime	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Transporti	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Konsulenca	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Reklamime në natyrë	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Shpenzime zyre elektorale	179,180	179,180	179,180	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Shpenzime administrative	3,786,793.80	3,786,793.80	3,786,793.80	Autofaturimet e qirasë së godinës që duhet të paraqiten në sist. tatimor nga vetë LSI-ja dhe gabimet e kontabil të shpenz. të	Nuk ka	+234,310.01	3,552,483.79

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

							pagave dhe të qirave	
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë								
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma përgjithshme e shpenzimeve të zgjedhore sipas auditimit	
Mitingjet/tubime dhe aktivitete të fushatës	190,000	190,000	190,000	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	190,000	
Materialet promovionale	487,120	487,120	487,120	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	487,120	
Media	8,078,482.71	8,078,482.71	8,078,482.71	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	8,078,482.71	
Media sociale	183,747.07	183,747.07	183,747.07	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	183,747.07	
Sondazhe								
Botime/publikime	-						-	
Transporti	-						-	
Konsulenca	-						-	
Reklamime në natyrë	-						-	
Shpenzime zyre elektorale	80,000	80,000	80,000	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	80,000	
Shpenzime administrative								
Shpenzimet zgjedhore								
Shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Vetëm kandidad Qendra	1 dhe

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatës zgjedhore: Për partitë politike 167.480.250 lekë ndërsa për kandidatët e pavarur 27.913.375 lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K465230365 NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Pasi kontrolluam të gjithë dokumentacionin fizik, (fatura, lëvizjet e llogarive, etj) ne vlerësuam se të gjitha shpenzimet e kryera janë në funksion të fushatës për zgjedhjet e pjeshme vendore. Raportet e partisë po ashtu edhe të kandidatëve mbështeteshin mbi dokumente fizike dhe reale, origjinale.
- Fushata ishte e ndarë: selia qendrore nuk kishte të përfshira në kostot e saj shpenzimet e kryera nga kandidatët. Subjekti kishte ndarë mënyrën e kryerjes së shpenzimeve, duke kaluar tek selia qendrore të gjitha shpenzimet të cilat nuk lidheshin me shpenzimet e kandidatëve.

18

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës :
 - o Shpenzimet për mitingjet për 190,000 lekë janë shpenzuar nga kandidatët e koalicionit "Shtëpia e Lirisë". Qendra nuk ka shpenzime për mitingje;
 - o Shpenzime për vendin/ambjentin: nuk ka;
 - o Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit: nuk ka;
 - o Shpenzimet e paisjeve: nuk ka;
 - o Shpenzimet për pijet: nuk ka;
 - o Shpenzimet e reklamave/promocioneve: nuk ka shpenzime për llogari të mitingjeve/tubimeve
 - o Shpenzimet e Transportit: nuk ka;
 - o Shpenzimet administrative: Nuk ka shpenzime administrative për llogari të mitingjeve/tubimeve
- **Materialet promociionale:** shpenz. promocionale janë kryer nga kandidatë në vlerën 487,120lekë; nga Qendra janë kryer shpenzime në vlerën 129,216.45 lekë. Shuma totale për kandidatët dhe Qendrën e LSI-së është në vlerën 616,336.45 lekë;
- **Media:** janë shpenzime të kryera nga Qendra në shumën 58,227.20 lekë ndërsa nga kandidatët shpenzimet janë sipas këtij detajimi (sipas përshkrimeve të bëra në faturat tatimore o kontratat e lidhura me kandidatët): spote televizive në vlerën 2,062,487.58 lekë, shpenzime marketingu në vlerën 6,015,995.13 lekë. Vlera totale e këtyre shpenzimeve është 8,078,482.71 lekë.
- **Media sociale:** janë shpenzime të kryera nga kandidatët (facebook apo fejsbuk) në shumën 183,747.02 lekë;
- **Sondazhe:** nuk ka;

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- **Botimet/Publikimet:** nuk ka;
- **Transporti:** nuk ka
- **Konsulenca:** studim tregu, kryer nga njëri prej kandidatëve në shumën 341,467.20 lekë
- **Reklamime në natyrë:** nuk ka
- **Shpenzime zyre elektorale:** janë shpenzime të qendrës në shumën 179,180 lekë; Shpenzimet në natyrë nga Qendra janë në vlerën 102,391 lekë ndërsa shpenzimet në natyrë për kandidatë janë në vlerën 170,551.01 lekë. Në total, shpenzimet në natyrë janë në shumën e llogaritur për 272,942.01 lekë.
- **Shpenzime administrative:** janë shpenzimet e raportuara nga Qendra në vlerën 3,786,793.80lekë. Janë raportuar më tepër +233,094.01 lekë;
- **Shpenzime bankare** 10,143.33 lekë të cilat nuk janë raportuar as si të ardhura dhe as si shpenzime..nga kandidatët.

19

IV. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- **Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve për raportimin financiar të fushatës zgjedhore të dt. 6 mars 2022 për zgjedhjet lokale të pjeshme të partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”:**

Nga kontrolli i kryer rezulton si më poshtë paraqitur:

- Vlerësimet e kontributeve në natyrë janë bërë sipas udhëzimit të miratuar me vendimin nr. 18, datë 14.04.2021 të Komisionit rregullator⁵. Nuk është llogaritur në të ardhura një diferencë prej 7,323 lekësh midis vlerës së qirasë të paguar me vlerën e qirasë të llogaritur sipas kërkesave ligjore;
- Të ardhurat dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore janë raportuar nga partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” për periudhën kohore 21.01.2022-04.03.2022.
- Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” liston në formularin 4 të saj “shpenzimet e partisë” shpenzimet e aktivitetit të saj operativ të periudhës 21.01.2022-04.03.2022;
- Nuk ka shpenzime që janë hërë 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve të cilat do të duheshin të llogariteshin në përcaktimin e tejkalimit të kufirit të shpenzimeve sepse edhe data e zgjedhjeve është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 13438,dt. 20.01.2022;

⁵ <https://kqz.gov.al/udhezime/>

Rr. “Milton Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Nuk ka përdorim të paligjshëm të burimeve shtetërore, të blerjeve të votave, pra nuk ka shpenzime të paligjshme.

○ Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit:

Në lidhje me respektimin e hapjes së llogarive të posaçme prej secilit kandidat dhe kryerjen e të gjitha veprimeve, të arkëtimeve nga dhuruesit (donatorët) e të likuidimit të furnitorëve nëpërmjet këtyre llogarive, u vërejtën këto situata:

- Nga gjashtë kandidatët e koalicionit, "Shtëpia e Lirisë", vetëm tre prej tyre i kanë shpallur llogaritë bankare në KQZ;
- Në një rast u vu re që, pavarësisht se është shpallur IBAN-i i një llogarie bankare, nuk është kryer veprim nëpërmjet saj por është bërë depozitim cash në llogarinë bankare të furnitorit;
- Në një rast, është raportuar në KQZ si llogari e posaçme për fushatën një llogari personale në të cilën paraqitet saldo e dt. 30.09.2021 e me të cilën nuk ka veprime të mëtejshme;
- Një nga kandidatët ka përdorur dy llogari personale të tij nëpërmjet të cilave janë arkëtuar sponsorizimet dhe janë likuiduar faturat e fushatës zgjedhore por asnjëra prej tyre nuk është e shpallur në KQZ;
- U vu re, gjithashtu, që janë kryer likuidimet e faturave nëpërmjet transfertave bankare, drejtpërdrejt, prej llogarive bankare të donatorëve tek llogaritë bankare të furnitorëve;

Respektimi i kërkesave të ligjeve fiskale dhe të regjistrimeve kontabël:

- Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim", raporton si shpenzime të qirave, të pagave dhe të sigurimeve shoqërore vlerat neto të tyre, pra sipas likuidimeve që kryen dhe jo vlerat bruto, siç e kërkon regjistrimi kontabël i tyre;
- Gjithashtu, kjo Parti nuk përpilon autofaturën për shërbimin e qirasë që blen nga dy qytetarë, në Tiranë e Durrës, siç e kërkon ligji tatimor.

Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertëve financiarë:

- Nga kontrolli i shpalljeve të raporteve të monitoruesve në faqen zyrtare të KQZ-së, rezulton të ketë dy denoncime për bashkinë Shkodër.⁶

⁶ https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/vendim_data_220228_Nr-105_Shqyrtim-i-denoncimit_bashkia-Shkoder-SHL.pdf



AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

B. PËRFUNDIMI

Opinionit pa rezervë

Ne kemi audituar raportin financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06 mars 2022, të cilat përfshijnë të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike "Lëvizja Socialiste për Integrim",

Sipas opinionit tonë, raporti financiar bashkëlidhur paraqet një pamje të drejtë të financave të fushatës zgjedhore të partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim" në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit "Shtëpia e Lirisë", i shtë regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06 mars 2022

Baza për opinionin

Ne kryem procedurat për auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme për të dhënë një bazë për certifikim me opinionin tonë pa rezerva.

21

AUDITUESE LIGJORE

Fatmira KASTRATI (SYKJA)



Tiranë, më 07 tetor 2022

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it